

Pro-Skills	
Vendi	Kosovë
Rajoni i projektit	Komuna e Pejës
Situata fillestare	<p>Potenciali dhe burimi më i madh i Kosovës mbetet rinia. Me reformat arsimore të ndërmarra kohët e fundit nga Qeveria e Kosovës, vëmendja që i kushtohet rinisë së Kosovës hap një dritare të re të shpresës për zhvillimin ekonomik nëpërmjet krijimit të ekspertëve të ri dhe të rinj.</p> <p>Një nga problemet kryesore me të cilat ballafaqohet rinia në Kosovë është mungesa e programeve specifike dhe të përshtatura të zhvillimit të arsimit dhe programeve të ndërtimit të kapaciteteve njerëzore, gjë që ka shkaktuar një shkallë të lartë të papunësisë. Në mungesë të këtyre programeve zhvillimore dhe perspektivës, një pjesë e madhe e rinisë ka tendencë për të emigruar në mënyrë ilegale.</p> <p>Programet arsimore nuk janë plotësisht në përputhje me kërkesat e tregut për fuqinë punëtore.</p> <p>Shkollat e AAP-së nuk po i përgatisin nxënësit për tregun e punës për shkak të mungesës së infrastrukturës, metodave të mësimdhënies dhe mungesës së mundësive praktike të mësimin. Puna praktike bëhet rrallë pasi që shkollave u mungojnë laboratorët apo kabinetet e punës në ndërtesë, mungesa e marrëveshjeve me bizneset e jashtme që mund t'i ndihmojnë shkollat duke i lejuar nxënësit të kryejnë praktikën në kompanitë e tyre.</p> <p>Një tjetër kufizim me të cilën ballafaqohen nxënësit është mungesa e informatave për karrierë si dhe mundësive për punësim dhe perspektivat.</p>
Objektivat	<p>Qasja e përmirësuar ndaj punësimin për të diplomuarit e rinj të shkollave profesionale për shkak të kërkesave përkatëse shtesë të tregut, praktikave të përfunduara dhe përmirësimit të bashkëpunimit në mes të sektorit privat dhe sistemit arsimor.</p> <p>Projekti duhet të trajtojë dy objektiva specifike;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbajtjen e trajnimeve të reja dhe praktikave në dispozicion të nxënësve nga shkollat profesionale me shkathtësi shtesë që janë relevante me tregun, 2. Arsimit profesional në fushën e turizmit, përpunimin e drurit, ICT dhe përpunimit të metaleve me një fokus të rritur në zhvillimin e shkathtësive relevante për treg.
Rezultatet e pritura	<p>1.1. Këshilli punues komunal është krijuar dhe ka vlerësuar mangësitë kryesore të trajnimit për arsimin dhe aftësimin profesional (AAP) për turizëm, ICT, përpunimin e metalit dhe drurit.</p> <p>1.2. Disejnimin dhe implementimin e trajnimeve të reja për nxënësit profesionistë i kanë adresuar disa nga mangësitë,</p> <p>1.3. Grupi Punues Komunal zhvillon, miraton dhe avokon së paku 2-5 koncepte që ndikojnë në përmirësimin e kurrikulit në shkollat e AAP-së.</p> <p>1.4. Rreth 150 nxënës/në vit të klasës 12-të pajisen me këshilla dhe mënyrën e aplikimit për punë dhe të kryerjes së punës praktike apo trajnimit në kompani;</p> <p>1.5 Së paku 15 kompani kanë iniciuar ofrimin e programit të praktikës dhe mentorimit,</p>

- 2.1. Zhvillimi dhe implementimi i trajnimeve profesionale i ka mbështetur **150 nxënës të klasës 12-të të AAP-së** për t'i rritur shkathhtësitë dhe kompetencat të cilat do t'i afrojnë të rinjtë në treg.
- 2.2. Të paktën 5-8 propozime për reforma për tejkalimin e pengesave strukturore janë formuluar dhe mbështetur nga një aleancë e gjerë dhe miratuar nga autoriteti përkatës.
- 2.3. **2 Shkollat e AAP-së në Pejë** kanë zhvilluar një platformë praktike/ të trajnimit në Internet për nxënësit e AAP-së.
- 2.4. **Rreth 30 kompani** në Pejë kanë përfitur fuqi punëtore të kualifikuar nga programet e trajnimit dhe ato praktike.

Përfituesit	<p>Shkolla ekonomike për AAP “Ali Hadri”, rreth 80 nxënës të klasave 10-11-të dhe 40 të klasave të 12-ta (statistika vjetore)</p> <p>Shkolla teknike për AAP “Shaban Spahija” rreth 425 nxënës të klasave të 10-11-ta dhe rreth 95 nxënës të klasës së 12-të</p> <p>Bizneset e ICT, industria turistike , përpunimi i metalit dhe drurit rreth 20 biznese në komunën e Pejës</p>
Partnerët	<p>Këshilli i Rinisë së Kosovës</p> <p>Këshilli i Rinisë së Kosovës (KRK) është një organizatë joqeveritare e rinisë (OJQ) e themeluar për t'i aktivizuar kosovarët e rinj për t'ju përgjigjur problemeve të tyre të shkaktuara nga dëbimi masiv nga shtëpitë e tyre për në Shqipëri në vitin 1999. Ai përfaqëson zërat e të rinjve; promovon arsimin e vetorganizuar, zhvillimin dhe argëtimin për të rinjtë; dhe përfshinë në mënyrë aktive të rinjtë në krijimin e politikave kuptimplota të rinjve.</p> <p>Instituti për Trajnim dhe Zhvillim Ekonomik ITZHE</p> <p>Instituti për Trajnim dhe Zhvillim Ekonomik (ITZHE) është një kompani shumë e përkushtuar, e ndërlidhur në mënyrë të gjerë, kompani vendore e Kosovës me përgjegjësi shoqërore, e formuar, regjistruar dhe me seli në Prishtinë. Si ofrues i trajnimeve ofron konsulencë dhe trajnime në; trajnimet për sektorin e financave, për sektorin publik, për SME, për shoqërinë civile, për nëpunësit administrativë, për punëkërkesit, trajnime profesionale, trajnime/shërbime të përshtatura, zhvillimin e kurrikulave etj.</p>
Kohëzgjatja	Data e fillimit dhe përfundimit të projektit janar 2017- dhjetor 2020
Personi përgjegjës, kontaktet dhe uebfaqja	<p>KYC, Lirona Rexhepi at lironarexhepipf@gmail.com</p> <p>www.kyc-ks.org</p> <p>ITED, Driton Berisha at dritonb@gmail.com</p> <p>www.ited-ks.com</p>